



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 9 / 5 , DATË 15 / 12 / 2020

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR MIRATIMIN E STATUSIT “PROJEKT
ME POTENCIAL STRATEGJIK JONIAN HEAVEN”, ME SUBJEKT
PROPOZUES JONIAN HEAVEN GROUP SHPK NUIS/NIPT L91404041V**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 14, nenit 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1024, datë 16.12.2015 “Për Miratimin e Projekteve me Statusin “Projekt me Potencial Strategjik”, Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi se:

- Projekti synon të realizojë një kompleks turistik me struktura akomoduese turistike, në ZK. 3831, Vrinë, specifikisht zona e quajtur ShënKoll i Detit, Sarandë, e cila në total ka një sipërfaqe prej afërsisht 128 Ha.
- Projekti parashikohet të ketë vlerë investimi prej afërsisht 78 (shtatëdhjetë e tetë) Milion Euro dhe të krijojë 443 (katërqind e dyzetë e tre) vende të reja pune.
- Projekti bashkëshoqërohet nga dy letra interesi, përkatësisht, Letër Interesi nga Accor Services Poland për Swiss Hotel, datë 03.02.2020 dhe Letër Interesi nga Holey Entertainment Group Limited për Casino, datë 19.02.2020.
- Projekti prek pasuritë nr. 1936/5, nr.1936/6, nr.1936/7 në ZK. Nr. 3831, pasuri pjesë e fondit pyjor dhe kullosor. Referuar të dhënave të regjistrit shtetëror kadastral, dy prej këtyre pasurive figurojnë me pronësi shtet dhe privat, në bashkëpronësi të papjestuar në natyrë. Pronësia private i përket një sipërfaqeje prej afërsisht 12.2 ha.

Pronarët e kësaj sipërfaqeje prej afërsisht 12.2 ha janë 19 (nëntëmbëdhjetë) individë, trashëgimtarë ligjorë të familjes Mustafa Kurani, në bashkëpronësi të pandarë.

- Pasuritë që prek projekti shtrihen në dy njësi strukturore. Njësia Strukturore XA.N.297, sistemi-natyror, përdorimi i lejuar: zona ekoturizëm, aktivitete sociale dhe reaktive. Njësia Strukturore XA.N.426, sistemi- natyror, nënkategori “ZPZT”, përdorimi i lejuar: zonë turizmi e integruar (resorte, vila); tipologjia - intesiteti i ndërtimit i ulët dhe maksimumi i lartësisë së strukturave 8 m. Kjo zonë kërkon hartim Plani të Detajuar të Zonës së Rëndësisë Kombëtare (PDZRK) pasi sipërfaqja ku propozohet të zhvillohet projekti “Jonian Heaven”, shtrihet brenda zonës së mbrojtur në Parkun Kombëtar të Butrintit, Zonë Qendrore, shpallur me VKM. 134, datë 20.02.2013 “Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit “Park Kombëtar”. Gjithashtu kjo zonë është shpallur edhe “Zonë Ramsar”, si dhe bën pjesë në Trashëgiminë Botërore të UNESCO-s. Sipas Konventës së Trashëgimisë Botërore, duhet njoftuar gjithashtu Komiteti i Trashëgimisë Botërore për çdo projekt që ndërmerret në zona që mbrohen nga kjo konventë.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Jonian Heaven”, me subjekt investues Jonian Heaven Group shpk, Vrinë, në ZK. 3831, Bashkia Konispol, në procedurat posaçme administrative favorizuese, lehtësuese apo përsheptuese që ofron statusi “projekt me potencial strategjik”.
2. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, projekt propozimi është jo i plotë, i pamundur të klasifikohet si “projekt me potencial strategjik” e të konsiderohet një projekt i mundshëm investimi me ndikim strategjik për zhvillimin e vendit dhe me

interes publik, në kuptim të parashikimeve të VKM Nr. 1024, datë 16.12.2015 “Për miratimin e projekteve me statusin “Projekt me Potencial Strategjik””.

3. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA